

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## ITALI/ SHQIPTARËT SHTOJNË BIZNESET E TYRE

Edhe pse pandemia **COVID-19** ka frenuar rritjen me ritmet e viteve të mëparshme, përsëri sipërmarrësit emigrantë shqiptarë kanë shënuar një shtim të bizneseve të tyre gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020. Dhoma Kombëtare Tregtare Italiane ka publikuar të dhënat e fundit statistikore të gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 mbi numrin e sipërmarrësve të huaj emigrantë në Itali. Pjesa më e madhe e bizneseve të emigrantëve shqiptarë është përqëndruar në sektorin e ndërtimit ku renditen të dytit në numër pas atyre me kombësi rumune e më pas në sektorin e tregtisë.


**PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU:** >>>>



## POLONIA ANULON FLUTURIMET ME SHQIPËRINË DERI MË 8 SHTATOR

Qeveria polake ka zbuluar planet e saj për të zgjatur ndalimin e disa fluturimeve ndërkombëtare nga 25 gushti deri më 8 shtator 2020 dhe për të rritur numrin e vendeve që do të vendosen në listën e ndalimeve nga 44 në 63 aktual për shkak të **COVID-19**. Një total prej 11,391 turistësh nga Polonia vizituan Shqipërinë në periudhën janar-korrik të vitit 2020, duke rënë 85.0% nga viti në vit.

**PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU:** >>>>



## NJOFTIMI I AMBASADËS, JA ÇFARË DUHET TË DINI PËR UDHËTIMIN DREJT ITALISË

Aeroporti “Nënë Tereza” në Facebook ka publikuar detajet që i ka bërë të ditura ambasada Italiane në lidhje me personat që duan të udhëtojnë drejt vendit fqinj. Udhëtimet Shqipëri - Itali (dhe anasjelltas) lejohen vetëm për arsye të përcaktuara, si: arsye pune, shëndetësore apo studimi, urgjence absolute, kthim në banesë apo vendbanim. Nuk lejohen, pra, udhëtimet për turizëm.

**PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU:** >>>>



## JAVA NË LAJME :

SHBA, KANADA DHE SUEDI/ SHKOLLAT SHQIPTARE  
FURNIZOHEN ME LIBRA NË GJUHËN SHQIPE



13 VENDET QË AMERIKANËT MUND T'I VIZITOJNË,  
SHQIPËRIA E PARA NË LISTË



TUZ/ PËR HERË TË PARË NJË PANAIR  
PËR LIBRIN SHQIP



60 FERMERË NË LUZ TË VOGËL KULTIVOJNË DOMATE  
PËR TË FURNIZUAR TREGJET E ITALISË



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104. <sup>70</sup>	105. <sup>70</sup>
EUR	123. <sup>70</sup>	124. <sup>30</sup>
CHF	114. <sup>70</sup>	115. <sup>80</sup>
GBP	137. <sup>70</sup>	138. <sup>80</sup>
DKK	16. <sup>20</sup>	16. <sup>70</sup>